



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria për Prokurim Publik

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. **"DIAMANTI" sh.p.k. me seli në Prishtinë, në procedurën prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanoc, Dumnicë, Pasomë, Beqiq, Duboc, Beqk, Stroc, Zhilivodë dhe në Prelluzhë", Nr.i prokurimit: VU644-23-6530- 5-1-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-074-511,** kundër Njoftimit për Kontratë të dt. 06.07.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik, më datën 14.08.2023 bie këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e datës 08.08.2023, e subjektit në procedurë : **"DIAMANTI" sh.p.k. me seli në Prishtinë,** për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, Njoftim për Kontratë të Autoritetit Kontraktues të datës 06.07.2023 lidhur me Kërkesat e FTD-së të saktësuara në Dosjen e Tenderit në aktivitetin e prokurimit: **"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanoc, Dumnicë, Pasomë, Beqiq, Duboc, Beqk, Stroc, Zhilivodë dhe në Prelluzhë", Nr.i prokurimit: VU644-23-6530- 5-1-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-074-511.**
2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik do të ndërmarr veprimet procedurale për korrigjimin dhe harmonizimin e **Kërkesave të FTD-së** , në pajtim me këtë vendim dhe në pajtim me korrigjimet e bëra nga Njësia Kërkuese e A.K.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Stanoc, Dumnicë, Pasomë, Beqiq, Duboc, Beqk, Stroc, Zhilivodë dhe në Prelluzhë", Nr.i prokurimit: VU644-23-6530- 5-1-1 & Nr. i brendshëm: VU644-23-074-511.**

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek.- Ankuesi, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, Op. Ek konsideron se **Kërkesat e saktësuara në FTD** shkelin nenin 1, 7, 27, 28, 69 dhe 71 të LPP-së, si dhe nenet 18.9 dhe 26.4 të RrPP-së, sepse, sikurse pretendon Ankuesi Kërkesat e saktësuara në **Kërkesat e FTD-së** të Dosjes së Tenderit, lidhur me mjetet dhe pajisjet në fjalë nuk janë në pajtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe si e tillë paraqesin kufizim të pjesëmarrjes së O.E. në aktivitetin e prokurimit në fjalë, me çka sikurse konsideron Ankuesi Parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim, janë shkelur dispozitat e LPP-së të cituara si më lartë në këtë Vendim.


Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, duke marrë për bazë dhe rekomandimin e Njësisë kërkuese të Autoritetit Kontraktues, lidhur me korrigjimin e **Kërkesave të FTD-së**, A.K. konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, për arsye se, sikurse ka vlerësuar Autoriteti Kontraktues, Kërkesa për pajisjen (**kamion me kran min. 12 ton paraqet lëshim teknik dhe zëvendësohet me kamion me peshë bartëse min. 7 ton**) dhe si të tillë, këtë Kërkesë do ta korrigjoj dhe përshtatë në harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit, respektivisht me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, ashtu që të jenë gjithëpërfshirëse.

Zgjidhjet e ndërmarra nga A.K. të cilat konsiderohen se i përmbushin dhe kërkesat dhe / ose pretendimet e Ankuesit, të saktësuara në Kërkesën për Rishqyrtim, A.K. do t'i inkorporoj në Dosjen e Tenderit në pjesën – **Kërkesat e FTD-së**, si dhe do t'i ngritë edhe përmes Platformës Elektronike, me qëllim të informimit të të gjithë O.E. të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha më lartë, dhe në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 074/2023, datë 08.08.2023

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik


Alban Tahiraj

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrij Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Vendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve;
2. DPP-së, dhe
3. Arkivit (1 kopje).